



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA	
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT	
Arkivi Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive	
Nr./Br./No.	3313
Nr. i fn./Br. Str./No. pg.	2
Data:	10.08.2023
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-279/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve –Glister Star i prodhuesit “Sinon Corporation”, Taiwan nga përfaqësuesi i saj "AgroVinifera" SH.P.K, Rahovec.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Herbicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Glyphosate acid.....360g/L

4. PËRDORIMI:

Glister star është një herbicid sistemik jo selektiv, pas mbirjes, i bazuar në glifosat me veprim foliar dhe aplikim të lokalizuar. Pas absorbimit nga gjetet, translokohet në rrënjët dhe organet e depozitimit, ku ushtron funksionin e tij si herbicid. Çaktivizohet shpejt nga toka, kështu që nuk ka asnjë efekt të mbetjeve. Kontrollon barërat e këqija një dhe shumëvjeçare në zonat e kultivuara, kanalet, hendekët dhe kullimet.

Fushat e përdorimit: para mbjelljes së kulturave barishtore gjethegjëra dhe gjethengushta njëvjeçare, kulturat druroe barërat e këqija një dhe shumëvjeçare, zonat që nuk janë të destinuara për kulturat bujqësore, zonat rurale dhe industriale, zonat ku kryhen punët civile.

Para mbjelljes se kulturave barishtore gjetje gjera dhe gjethe ngushta një vjeçare 1,5-6 l/ha
Kultura drurore:3-6L/ha për kontroll te barërave te këqija një vjeçare ,6-10 L/ha për barërat e këqija
shume vjeçare.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

10ml-100L

6.VËREJTJE:

Glister Star duhet të përdoret duke shmangur kontaktin me bimë të dobishme si psh. Kulturat që mund të tregojnë ndjeshmëri nëse kërcelli ndikon në trung, fidanishtet dhe shtretërit e luleve me lule, bimë dekorative. Pyje dhe pemë. Kulturat në të cilat absolutisht duhet të shmanget çdo kontakt, trëndafil, fidanishte, në kulturat para qeljes së sythave lulore, tokat bujqësore në djerrinë, zonat jo të destinuara për kulturat bujqësore.

7. KARENCA:

Nuk aplikohet.



8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:

GHS09- paralajmerim (cat 1)-i rrezikshëm për ambient.

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar ne Databazën e Pesticideve te BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV/ZKM;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.

